INTERVISTA

Dëshmi mbi disa elementë paleokristianë janë zbuluar në Bogovë të Skraparit. Një ekzemplar i plastikës dekorative arkitektonike, i cili paraqet një shembull unik për Shqipërinë, por edhe për hapësirën mesdhetare, është bërë objekt studimi i specialistëve

DRITAN ÇOKU:

Gjetja e rastësishme pranë Osumit, unike për nga dekorimi



Në foto: Dritan Çoku





Në foto: Kolonat e gjetura në Berat

Abedin Kaja

Kolona paleokristiane, zbulohet ekzemplari i rrallë në Bogovë

Një kolonë dyfishe e cila gjen përdorim në bazilika pale okristiane është zbuluar disa ditë më parë në Bogovë. Studiuesi Dritan Çoku thotë se kjo kolonë e gjetur nga disa punime të rastësishme, është një ekzemplar unik jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për hapësirën mesdhetare. "Duke e quajtur bazilikë peshkopale kemi parasysh lokalizimin pranë Beratit (Pulheriopoli i dikurshëm) si një qendër mjaft e rëndësishme peshkopale, po ashtu edhe Gradicion, një qendër e re peshkopale e krijuar gjatë asaj kohe si rezultat i ndryshimeve në organizimin territorial nga ana e pushtetit qendror", - shton Çoku. Në intervistën e mëposhtme ai tregon rëndësinë e këtij zbulimi.

Këtë radhë i keni zhvendosur studimet në Skrapar. Çfarë iu shtyu të shkonit në këtë zonë?

Rrethi i Skraparit ka larmi të monumenteve të arkitekturës, që sipas kriterit kohor klasifikohen në monumente prehistorikë (1,5 milion vjet p.e.s - shek.V p.e.s), monumente antike (shek.V p.e.s - shek.VI e.s), monumente mesjetare (shek.VI - shek XV-të), monumente të kohës së re (shek.XVI - fillim shek.XX) dhe monumente bashkëkohore (fillim i shek.XX e këtej). Ky studim synon të paraqesë disa dëshmi të reja të kohës së vonë antike, të sjellë elemente që kanë qenë pjesë e formulimit arkitektonik të një ndërtimi kulti kristian, mendojmë të gjysmës së parë të shek.VI. Ndër to, tërheq vëmendjen një ekzemplar i gjetur në fshatin Bogovë të rrethit të Skraparit, i cili paraqet një shembull unik për Shqipërinë, por edhe për hapësirën mesdhetare.

Kjo ka qenë një gjetje rastësore?

Po, ka qenë një gjetje rastësore gjatë punimeve që po bëheshin për ndërtimin e një objekti. Elementi është një kolonë dyfishe e cila gjen përdorim në bazilika paleokristiane. Ky ekzemplar i plastikës dekorative arkitektonike tregon se bazilika ka qenë një ndërtim monumental. Ajo përbën një gjetje me shumë vlerë, sidomos për studimin e plastikës së kohës së vonë antike. Mendojmë se këto elemente dëshmojnë për një monument kulti të rëndësishëm, për një bazilikë peshkopale të antikitetit të vonë (284-565) dhe të mesjetës së hershme (565-850). Duke e quajtur bazilikë peshkopale kemi parasysh lokalizimin pranë Beratit (Pulheriopoli i dikurshëm) si një qendër mjaft e rëndësishme peshkopale, po ashtu edhe Gradicion, një qendër e re peshkopale e krijuar gjatë asaj kohe si rezultat i ndryshimeve në organizimin territorial nga ana e pushtetit qendror. Gradicion, (Gradeci i sotëm, zonë në afërsi të qytetit të Çorovodës), për të cilin Sufflay dhe Ducellier mendojnë se kemi të bëjmë me Gradishtën e Hekalit në Mallakastër, që është Bylisi i Antikitetit. Sipas Prof. Dr. Aleksandër Meksit, një gjë e tillë është e gabuar përderisa aty pranë kemi Gllavenicë-Ballshin. Profesor Meksi na informon se kjo qendër peshkopale i takon Gradecit, Tomorit, ose Skraparit. Është pra pikërisht kjo qendër peshkopale që shfaqet për një kohë të shkurtër duke iu nënrenduar më vonë, si edhe më parë, Gllavenicë-Pulheriopolisit.

Mund ta ilustroni me shembuj konkretë këtë që po thoni?

Ky ekzemplar, jo vetëm si element arkitektonik, por edhe për nga zbukurimorja i takon plastikës dekorative arkitektonike të hershme bizantine, këtë rast jo në kalanë e Beratit, por në Bogovë nga lugina e sipërme e Osumit. Kolona e dyfishtë, është formë tipike për ndarjet e dritareve në bazilikat paleokristiane dhe të hershme bizantine. Duhet theksuar se kolona e dyfishtë është e ngjashme me ato të Beratit, të Bylisit etj., por është unike për sa i përket gdhendjes dhe dekoracionit shumë të pasur, të përdorur sidomos në njërën anë të saj. Nga materiali duket gur gëlqeror, ndërsa nga punimi mendojmë se kemi të bëjmë me një punë mjaft të bukur vendase, madje sot hedhim hipotezën për herë të parë që ky dekoracion të jetë realizuar nga të njëjtët mjeshtra që kanë realizuar dekoracionin e relikuarit të Beratit, kolonat e dyfishta që gjenden në kishat e kalasë së Beratit, por edhe kapitelet në kishën e Shën Kollit në Perondi.

Çfarë përmase kanë këto kolona?

Përmasat e kolonës janë me gjatësi 34.5cm, gjerësi 17cm dhe lartësi 72cm. Mbi reliefin e saj në njërën anë është gdhendur një kryq (fig.2), ndërsa në anën tjetër në gjithë gjatësinë e faqes së kolonës është gdhendur motivi i gërshetës së vazhdueshme, ku brenda hapësirave të saj janë gdhendur disa simbole (fig.1,3). Ky motiv është i përdorshëm edhe në dyshemetë e zbukuruara me mozaik në kohën e vonë antike (284-565). Shembullin e motivit të gërshetit të vazhdueshëm e gjejmë edhe në mozaikë të shek.III, në një shtëpi banimi të një qytetari të pasur në Apolloni, (Skënder Animali, Stilian Adhami, Mosaiques de l'Albanie, 8 Nëntori, Tiranë, 1974, f.11) në mozaikun e Tiranës, por edhe në disa pilastra dekorative arkitektonike, të shek.VI si kohë e ndërtimit të parë të bazilikës së Ballshit (Skënder Animali, "Bazilika e Ballshit", "Iliria", VII-VIII, 1977-1978, Tiranë, f.304). Madje tek këto pilastra vihen re motivet zbukuruese brenda gërshetit nga bota shtazore e bimore, por duke e krahasuar me punimin e kolonës dyfishe të Bogovës, është një punë më e dobët. Kjo kolonë dyfishe është zbukuruar me motive simbolike, dhe saktësisht në qendër të gërshetës është punuar një lule me tetë petale, ndërsa në dy hapësirat e tjera të gërshetit mbi dhe nën lule është gdhendur nga një pëllumb, të njëjtë në punim, por të vendosur në drejtime të kundërta horizontale. Simbolet janë të qarkuara brenda gërshetit me motive bimore.

Përse përdoreshin zbukurimet bimore dhe cila është e veçanta e kolonës së zbuluar në Bogovë?

Motivet zbukuruese bimore janë përdorur në mbushjen e zbrazëtirave përreth zbukurimeve kryesore. Tek punimi spikat dora e një mjeshtri, që i njeh mirë dhe që i skalit me mjaft shije e plastikë elementët dekorativë që vijnë nga bota shtazore e bimore, dhe në përgjithësi të atyre simboleve dhe motiveve zbukuruese të pranuara nga krishterimi, në fazën e parë të përhapjes së tij. Dekoracioni, si një faktor shtytës i konceptimit artistik dhe fetar është përdorur në kapitele, në shtyllat anësore dhe harkun që përbëjnë hyrjen në sanktuar (vend i shenjtë përreth altarit në kishat e krishtera), në pllaka altari të kishave të hershme bizantine, por gjatë hulumtimit midis shumë kolonave të dyfishta të evidentuara deri tani, si në kalanë e Beratit, por edhe në hapësirën shqiptare nuk gjejmë asnjë paralele, jo vetëm në Shqipëri por edhe në hapësirën mesdhetare. Elementi tjetër është një kapitel i dyfishtë; (fig.4) në njërën anë ka të gdhendur një kryq në relief, ndërsa ana tjetër është e dëmtuar. Ky element vendosej mbi kolonën e dyfishtë.

Ku mendoni se është vendorigjina e tyre?

Për vendorigjinën e saktë të tyre duhen realizuar sondazhe pranë objektit në të cilin janë gjetur këta elementë, por kemi edhe një arsye tjetër për të menduar mbi vendorigjinën e tyre. Në një kodër të vogël, në fshatin Jaupas, pjesë e komunës Bogovë, janë zbuluar gjurmë mozaiku. Kodra ndodhet në të djathtë të rrjedhës së lumit Osum, 500m larg rrugës nacionale Berat-Skrapar. Sipas një raporti të ekspeditës përnjohëse të projektit "FOAP" në rrethin e Skraparit, tetor 2006, përballë kodrinës në veriperëndim ndodhet një shkëmb i mbuluar me vegjetacion, i njohur nga banorët me toponimin "kisha". Atëherë natyrshëm lind pyetja: Mos vallë vendndodhja e këtyre elementëve arkitektonikë nuk është në vendin e gjetjes së tyre por në zonën ku është gjetur mozaiku, dhe kanë bërë pjesë në formulimin arkitektonik të një kishe paleokristiane? Gjithsesi, për të nxjerrë përfundime të mëtejshme fjalën e fundit do e japin gërmimet e ardhshme arkeologjike.

PROMOVOHET BILETARIA ELEKTRONIKE NË BUTRINT

Parku Kombëtar i Butrintit do të jetë parku i parë në Shqipëri ku do të funksionojë sistemi elektronik i biletave. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe AADF (Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit) kanë përuruar dje këtë sistem të financuar nga këto dy institucione. Parku Kombëtar i Butrintit është parku më i rëndësishëm në vend që tërheq gjithnjë e më shumë interesin e vizitorëve, veçanërisht atyre të huaj. Sipas MTKRS-së, ofrimi i AADF si një aktor shumë i rëndësishëm në ndihmë të përmirësimit të menaxhimit të Parkut të Butrintit, procesi i hartimit të planit të menaxhimit mjedisor të Butrintit dhe udhëzimi i përbashkët me Ministrinë e Financave për përdorimin e të ardhurave të Parkut të Butrintit nga vetë Parku, janë disa nga treguesit e një procesi që tashmë ka nisur për kthimin e Butrintit në një sit arkeologjik dhe qendër turistike ndër më të rëndësishmet në Mesdhe. Përurimi u bë dje nga ambasadori amerikan Aleksandër Arvizu dhe ministri Aldo Bumçi. Sipas Rajmond Kolës, drejtor i Parkut Arkeologjik të Butrintit, vënia në funksionim e kësaj biletarie, jo vetëm që modernizon këtë shërbim dhe shkurton kohë, por mbyll edhe çdo mundësi spekulimi me biletarinë dhe të ardhurat e siguruara prej saj. Ministri Bumçi ka shprehur kënaqësinë për praninë e ambasadorit amerikan, ndërsa ky i fundit, tha se qeveria amerikane ka qenë mjaft e përfshirë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën dhe për këtë ai vlerësoi kontributin e dhënë nga ana e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan. tho.ni



Në foto: Ministri Bumçi dhe ambasadori amerikan Arvizu, dje në Butrint